



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina

KOMUNA E PRISHTINËS

01.nr. 085-157729 më 23.06.2016

Në mbështetje të dispozitave të nenit 37, pika 2, nenit 56, pika 1, nenit 77, pikat 1 dhe 2, si dhe nenit 91, pika 5 të Ligjit nr. 04/L-027, për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit nr. 03/L - 040, për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), Planit të Reagimit Kombëtar, dhe nenit 52 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, duke pasur për bazë gjendjen e krijuar për sigurinë e qytetarëve nga kërcënimi i pelcitjes së gypit kryesor të ujsjellësit në lagjen "Velani", Kryetari i Komunës së Prishtinës, më 23.06.2016, merr këtë;

V E N D I M :

- I. Me këtë vendim ngritet shkalla e gatishmërisë emergjente në këtë pjesë të qytetit.
- II. Mobilizohet struktura e sistemit të mbrojtjes, shpëtimit, ndihmës, KUR"Prishtina" dhe shërbimeve të tjera emergjente, të cilat do të merren me sanimin e gjendjes, rregullimin e terrenit në mënyrë që gypi i ujit të sigurohet për të zvogëluar rrezikun e qytetarëve, në koordinim me Komitetin e Krizave.

Arsyetim

- III. Pas konstatimit të ekipeve profesionale të Komunës dhe atyre të KUR"Prishtina" për mundësinë e shpërthimit të gypit kryesor të ujsjellësit që e furnizon një pjesë të madhe të qytetit, i cili përveç që do të shkaktoje dëme të mëdha në këtë lagje, qyteti do të mbetej pa ujë së paku dy-tri javë (ky është konstatim i ekipeve të ujsjellësit).
- IV. Për sanimin e gjendjes do të angazhohet një kompani profesionale e cila në bashkëpunim me ekipin profesional të Komunës dhe KUR"Prishtina" do ta mbikëqyrin ecurinë e punës.
- V. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Komisioni i posaçëm i formuar nga Komuna dhe KUR"Prishtina" .
- VI. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

Ky vendim ti dërgohet:
Anëtarëve të komisionit,
Qendrës për punë me qytetar,
Zyrës së prokurimit .

